UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1915/2 Prot.

Durrës, më 18.11.2019

**VENDIM**

**Nr 64, datë 18.11 2019**

**PËR**

**"MIRATIMIN DHE SHPËRNDARJEN E BURSAVE, PËR VITIN AKADEMIK 2019-2020, TË CILËT PËRMBUSHIN KRITERET PËR PËRFITIMIN E BURSAVE NGA FONDI I MBËSHTETJES STUDENTORE PËR STUDENTËT QË STUDIOJNË NË PROGRAME STUDIMI NË FUSHAT PRIORITARE DHE STUDENTËT NË NEVOJË, QË NDJEKIN STUDIMET NË CIKLIN E PARË TË STUDIMEVE, PRANË UNIVERSITETIT "ALEKSANDËR MOISIU", DURRËS".**

Në zbatim të ligjit nr. 8480, datë 27.5.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", nenin 49 të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në Insitucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 903, datë 21.12.2016, të ndryshuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 784, datë 26.12.2018 "Për disa ndryshime në Vendimin nr. 903, datë 21.12.2016, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kritereve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë", të ndryshuar me Vendimin nr. 39, datë 23.01.2019 të Këshillit të Ministrave, shkresës nr.1888/1 prot, datë 15.11.2019 të FE, shkresës nr.646 prot, datë 15.11.2019 të FB, shkresës nr.628 prot, datë 08.11.2019 të FB, shkresës nr.1888/2 prot, date 15.11.2019 të FSP, shkresës nr. 683, date 18.11.2019 të FSP, shkresës nr.1748/3 datë 14.11.2019 së FSHPJ, shkresës nr.1836 prot, date 07.11.2019 të FSHPJ, shkresës nr.1836/1, date 7.11.2019 të FTI, shkresës nr.1888 datë 14.11.2019 të FASTIP, Bordi i Administrimit të Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës, në mbledhjen e datës 19.11.2019,

**VENDOSI:**

1. Shpërndarjen e bursave, për vitin akademik 2019 - 2020, për studentë të cilët vijojnë studimet në vitin e parë dhe pas të parit në ciklin e parë të studimeve dhe vijnë nga shtresa sociale si kategori në nevojë sipas listës bashkëlidhur të hartuar nga komisioni i verifikimit të bursave, 222 studentë, efekti financiar 19980000 lekë.
2. Shpërndarjen e bursave, për vitin akademik 2019 - 2020, për studentët e shkëlqyer të cilët vijojnë studimet në vitin e parë dhe pas të parit në ciklin e parë të studimeve, sipas tabelës bashkëlidhur 64 studentë, efekti financiar 5760000 lekë.
3. Efektet financiare për mbulimin e shpenzimeve për shpërndarjen e bursave për keta studentë, për vitin akademik 2019 – 2020 të miratuar në pikën 1 të këtij Vendimi, do të përballohen nga fondet e buxhetit të shtetit (granti) i miratuar , nga Ministria e

Arsimit, Sportit dhe Rinisë, për vitin 2019 dhe 2020, për Universitetin "Aleksandër Moisiu", Durrës.

4. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi:
   - Administratori
   - Drejtoria e Administrimit Financiar

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Kryetar i Bordit të Administrimit**
**Ilirjana NANO**